QSP/CPS

# BULETIN

RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.23 Korrik 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave qershor 2005

**I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 31.05.2005**

**VENDIME**

**1.** Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët.

**2.** Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik.

**3.** Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994. Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

**4.** Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, shtëpi banimi e cila realizohet nga linja e tensionit.

**5.** Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin fianciar, 1997, "Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit-komponenti i furnizimit me ujë të pijshëm".

**6.** Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar, 2004, për projektin "Shtesë kapitali/ masa shoqëruese për mbrojtjen e mjedisit të Liqenit të Ohrit - Komponenti i kanalizimeve të ujrave të zeza".

**7.** Për një ndryshim në vendimin nr. 231, datë 15.4.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë së zhvillimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), në kuadër të programit të komunitetit të energjisë së Europës Juglindore".

**8.** Për miratimin në parim të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Hollandës, për programin "Për bashkëpunimin me tregjet në zhvillim (PSOM)".

**9.** Për miratimin në parim të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), për dispozitat e mbështetjes së vendit pritës, për forcat pjesëmarrëse në stërvitjen "Cooperative Engagement 05".

**10.** Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr.60, datë 21.2.1994, të Këshillit të Ministrave "Për dhënie toke në përdorim 577 familjeve fshatare, banorë të ishndërrmarrjes bujqësore Ksamil", të ndryshuar.

*(Vijon në faqen 2)*

## Në këtë numër do të lexoni:

*1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin maj 2005* — *faqe 1-5*

*3. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore* — *faqe 6*

*4. Njoftim* — *faqe 1, 6*

## Njoftim

***Të nderuar zonja e zotërinj,***

*Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare.*

*Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publikepër krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, infomacionin mbi dokumentat zyrtare.*

*(Vijon në faqen 8)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 1)*

**11.** Për rishpërndarje fondësh buxhetore, ndërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, për vitin 2005.

**12.** Për lejimin e Kryeministrisë të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me telekamera në mjediset e brendëshme dhe të jashtme të kryeministrisë dhe Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të klasifikuar, për përmirësimin e shërbimit të sigurisë.

**13.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për objektin "Sistemim e Asfaltim, rruga hyrje-dalje,Pogradec".

**14.** Për miratimin e vlerës së aksioneve, pronë e shtetit shqipërtar, të bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

**15.** Për një shtesë në vendimin nr.424, datë 9.7.1998, të këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

**16.** Për lejimin e Ministrisë së Financave të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për përzgjedhjen e konsulentit ligjor, për shitjen e aksioneve të shtetit shqiptar në bankën e Bashkuar të Shqipërisë.

**17.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të rrugëve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për vazhdimin e punimeve në segmentin rrugor Milot- Rrëshen, pjesë e aksit rrugor Durrës- Kukës-Morinë.

**18.** Për përcaktimin e koefiçentëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve.

**19.** Për rritjen e pensioneve.

**20.** Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve.

**21.** Për rritjen e trajtimeve financiare të veçanta.

**22.** Për disa shtesa në vendimin nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmin", të ndryshuar.

**23.** Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objekteve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëdetësor, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithëshme të Përmbarimit Gjyqësor, Zyra e Përmbarimit Vlorë.

**24.** Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Orikum – Dhërmi.

**25.** Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i kanaleve kulluese-vaditëse, të dëmtuara nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Kakavijë-Gjirokastër.

**26.** Për miratimin e vlerës së aksioneve të bankës Italo – Shqiptare.

**27.** Për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Ministrisë së rregullimit të territorit dhe të turizmit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit për vitin 2005.

**II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 9.6.2005**

**PROJEKTLIGJE**

*(Vendime të Këshillit të Ministrave për propozime projekligjesh)*

**1.** Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit, të vitit 2004.

**2.** Për disa ndryshime në ligjin nr.8744, datë 22. 2.2001, "Për trasferimin e pronave të paluajtsheme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".

**3.** "Për ratifikimin e marrëveshjës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë dhe qeverisë Maqedonase, për shërbimet ajrore, ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive.

**VENDIME të Këshillit të Ministrave data 9.6.2005**

**1.** Për caktimin e komisioneve për përballimin e shpenzimve të shqyrtimit dhe korrespondencës për dhënie dhe rinovim lincensash, autorizimesh dhe miratimesh nga Auoriteti Mbikqyrës i Sigurimeve.

**2.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiarë, 2000 dhe 2001.

**3.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiarë në projektin "Shkarkimin e ujrave të zeza, Korçë 3".

**4.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 1999, në projektin "Shtesë fondesh për furnizimin me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut –Bistrica 2 – financim i përzier".

**5.** Për miratimin në parim të marrëveshjes për ndryshime në marrëveshjen e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillimin (IDA) për projektin e zhvillimit të burimeve natyrore, (Granti nr. TF 053121).

**6.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për projektin e veprimtarisë së aftësimit

***(Vijon në faqen 3)***

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 2)*

Vlerësimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve për prioritetet e strategjisë dhe planit të veprimtarisë për biodiversitetin e Shqipërisë".

**7.** Për miratimin në parim të protokollit të zbatimit të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për pranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim në shtetet e Beneluksit, (Mbretëria e Belgjikës, Dukati i madh i Luksenburgut, Mbretëria e Vëndeve të Ultëa), ose ne Republikën e Shqipërisë.

**8.** Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasuritë së paluajtshëme, pronë private, që përket nga ndërtimin i nënstacionit 120/20kv, Porto-Romano, Durrës.

**9.** Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshëme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës dhe rehabilitimi i kanalizimeve në shëtitoren " 18 shtatori", në qytetin e Gjirokastrës.

**10.** Për disa ndryshime në vendimin nr. 405, datë 8.1.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për administrimin e mjetit rrugëor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës të Shqipërisë, të ndryshuar.

**11.** Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit "Zyra dhe oficina "Sarandë, nga Ministria e Buqësis dhe e Ushqimit, Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit , dhe të objektit "Ish – parku i mallrave", Sarandë, nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacioni, Ministrisë së Bujqësis dhe të Ushqimit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave"Për miratimin e listës së inventorit të pronave të paluajtshme shtetërore së Drejtoris së Përgjithëshëme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat I kalojnë në përgjëgjësi administrimin Ministrisë së Transporti dhe të Telekomunikacionit".

**12.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në bashkinë e Sarandës ,qarku I Vlorës.

**13.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në bashkinë eCorovodës, qarku Berat.

**14.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në bashkinë e Bbulqizës, qarku Dibër.

**15.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në bashkinë e Sukthit, qarku Durrës.

**16.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në komunën e Frakullës,qarku Fier.

**17.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në komunën e Cibonikut, qarku Korcë.

**18.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në komunën e Drenovës, qarku Korcë.

**19.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në komunën e Carravës, qarku Korcë.

**20.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, në komunën eQesarit, qarku Gjirokastër, qarku nDurrës.

**21.** Për miratimin e listës paraprakete pronave të paluajtëshme,publike, shtetërore, që stranferohen në pronënsiose në përdorim bashkisësë Elbasanit, qarku Elbasanë.

**22.** Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtëshme, publike, shtetërore, që s'tranferohen në pronënsiose në përdorim bashkisë së Pogradecit, qarku Pogradec.

**23.** Për miratimin e listës parapraketë pronave të paluajtëshme, publike, shtetërore, që stranferohen në pronënsiose në përdorim bashkisë së Gramshit, qarku Elbasan.

**24.** Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtëshme,publike, shtetërore, që stranferohen në pronënsiose në përdorim bashkisë së Divjakës, qarku Fier .

**25.** Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtëshme,publike, shtetërore, që stranferohen në pronënsiose në përdorim komunës së Dushkut, qarku Fier.

**26.** Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtëshme,publike, shtetërore, që stranferohen në pronënsiose në përdorim komunës së Golemit qarku Fier.

**27.** Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtëshme, publike, shtetërore, që stranferohen në pronënsiose në përdorim komunës së Voskopit, qarku Korcë.

**28.** Për dhnie municioni Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në kuadër të bashkpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.

**29.** Për një shtesë në vendimin nr. 412, datë 15.9.1992, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për dhënien e licencave profesionale" të ndryshuara.

**30.** Për shpronësimin për interesa publike, të pronarit të pasuritë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Shijakut.

**31.** Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës "BOO" të hidrocentraleve Stranik dhe Zall-Tore, në komunën Stravaj, Librazhd, si propozimi i pakërkuar.

**32.** Për miratimin në propozim të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Re-

*(Vijon në faqen 4)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 3)*

publikës së Shqipërisë dhe Bankës Evuropiane të Investimeve (BEI), për financimin e projektit të rehabilitimit dhe të ndërtimit të rrugës Fier (Levan) –Tepelenë .

**33.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurorim I drejtëpërdrejt "për objektin " Sistemi e asfaltimi, rruga Shirokë-Zogaj".

**34.** Për lejimin e Ujsjellës – Kanalizimeve , Durrës, sha, të përdorë procedurën "Prokurorim I drejtëpërdrejt "për relizimin e punimeve për ndërtimin e ujësjellsit të fshatit Reth – Pjezës , komuna Xhafzotaj, Durrës.

**35.** Për disa ndryshime në vendimin nr. 124, datë 2.3.2005 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e numërimit të punojsve buxhetarë të ministrive dhe institucioneve qëndrore për vitin 2005 të ndryshuar.

**36.** Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave ," Për strukturën dhe pagat e punojësve të Policisë së Ndërtimit", të ndryshuar.

**37.** Për disa ndryshime në dokumentin "Rregullorja e shërbimit të lashtëm të Republikës së Shqipërisë ", miratuar me vendimin nr.839, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

**III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 16.6.2005**

**PROJEKTLIGJE**

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

**1.** Për një ndryshim në ligjin nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtëshme të shtetit."

**VENDIME të Këshillit të Ministrave data 16.6.2005**

**1.** Për kushtet, kriteret dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar i punonjësve të Policisë së shtetit dhe anëtarëve të familjeve të tyre në rastet kur punonjësi ndërpret karrierën.

**2.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për qendrën e Realizimit të Veprave të Artit, për realizimin e veprës monumentale, kushtuar nxënësve kosovarë, që humbën jetën në aksidentin në Fushë-Arrëz, Pukë.

**3.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë dhe të financimit ndërmjet republikës së Shqipërisë, Kreditaustalt fur Ëienban (KFË) Frankfurt am Main, dhe fondacionit "Fefad", për projektin "Promovimi SME-ve".

**4.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për ruajtjen e kantiereve të rrugës Rrogozhinë-Elbasan.

**5.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

**6.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithëshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit.

**7.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave.

**8.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të regjistrimit të pasurive të Paluajtëshme.

**9.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

**10.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.

**11.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjensisë Telegrafike Shqipëtare.

**12.** Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.675, datë 20. 12. 2002 të këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve buxhetore, të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet" ndryshuar.

**13.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimevetë kurimit të zotit Gentian Shkoza, jashtë shtetit.

**14.** Për një shtesë në vendimin nr.159, datë 13.3.2003 të këshillit të Minsitrave, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe procedura e shitjes" të ndryshuar.

**15.** Për transferimin në pronësi të komunës Labinot-Fushë të mjediseve të pronës "Grup depo të repartit ushtarak nr.8833", në Mengel, Elbasan në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

**UDHËZIM:** Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të këshillit të ministrave, "Për Prokurim Publik" të ndryshuar.

**IV. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 23.6.2005**

**PROJEKTLIGJE**

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

**1.**Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të ministrave të

***(Vijon në faqen 5)***

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 4)*

republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rehabilitimit dhe ndërtimit të rrugës Fier (Levan) – Tepelenë.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Sllovake, për ristrukturimin dhe shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Sllovake.

**VENDIME të Këshillit të Ministrave data 23.6.2005**

**1.** Për miratimin e strategjisë dhe planit kombëtar të veprimit, për zbatimin e konventës së Arhusit.

**2.** Për miratimin e listës së pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese.

**3.** Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor jopublik, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithëshme e profilizuar "Turgut Ozal" që do të zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

**4.** Për shpalljen "Qendër Historike" dhe "Ansambël urbanistik, arkitektonik, tradicional", të disa zonave të qytetit të Korçës, si edhe miratimin e rregullores së administrimit të tyre.

**5.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.

**6.** Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Principatën e Audorës.

**7.** Për miratimin në parim të letërmarrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për përdorimin e grantit hollandez (TF 054399), për rimëkëmbjen e zonave të ndotura në Porto-Romano, në kuadër të përgatitjes së projektit të menaxhimit të integruar dhe pastrimit të zonës bregdetare.

**8.** Për miratimin në parim të marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

**9.** Për miratimin në parim të memorandumit të mirkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë të Republikës së Kroacisë, e qeverisë së republikës së Maqedonisë, për stërvitjen "Adriatik Engagement 05".

**10.** Për heqjen e disa armëve trofe nga lista e inventarit të armatimit të Forcave të Armatosura.

**11.** Për një shtesë në vendimin nr.112, datë 8.3.2001 të këshillit të Ministrave "Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore".

**12.** Për lirimin dhe emërimin në detyrë të një anëtari të këshillit Mbikqyrës të Agjencisë së Trajtimit të kredive.

**13.** Për dhënie fondi shtesë shoqatës së invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë.

**14.** Për rishpërndarje fondesh buxhetore ndërmjet ministrive dhe institucioneve qëndrore, për vitin 2005.

**15.** Për përcaktimin e pagës minimale, në shkallë vendi.

**16.** Për shperblimin e ushtarakëve pjesëmarrës në operacionin "Althea" të bashkimit Europian, në Bosnjë Hercegovinë.

**17.** Për miratimin e projekt-shtojcës së kontratës, ndërmjet qeverisë së republikës së Shqipërisë dhe "Lockheed Martin Global inc", për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar.

**18.** Për lejimin e Komitetit Shtetëror të kthimit dhe Kompensimit të pronave, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerje pajisjesh elektronike.

**19.** Për lejimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të pronave të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerje pajisje zyrash.

**20.** Për lejimin e Komitetit Shtetëror të kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerje autoveturash.

**21.** Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të disa ndërrmarrjeve publike.

**22.** Për miratimin e listës së inventarit të ish-ndërrmarrjes së grumbullimit, Fier, dhe transferimin e katit përdhes të saj në pronësi të bashkisë së Fierit.

**23.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të rrugëve të përdorë procedurën "Kërkesë për kuotim", për objektin "Sistemim Asfaltim" rruga Laç – Kisha e Shën Ndout (pjesa e parë).

**24.** Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 382, datë 20.5.1996, të këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese, dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar.

**25.** Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Rpublikës së Austrisë, për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave.

**26.** Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ndërkombëtar rrugor.

# Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

**Kuvendi i Shqipërisë**
www.parlament.al

**Presidenca** www.president.al

**Këshilli i Ministrave**
www.keshilliministrave.al

**Ministria e Financave**
www.min.fin.gov.al

**Ministria e Mbrojtjes**
www.mod.gov.al

**Ministria e Mjedisit** www.moe.gov.al

**Ministria e Shëndetësisë**
www.moh.gov.al

**Ministria e Rendit Publik**
www.mpo.gov.al

**Ministria e Punëve të Jashtme**
www.mfa.gov.al

**Ministria e Arsimit dhe e Shkencës**
www.mash.gov.al

**Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit**
www.mpvd.gov.al

**Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit**
www.mtt.gov.al

**Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit**
www.mbu.gov.al

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**
www.mkrs.gov.al

**Ministria e Industrisë dhe Energjitikës** www.meep.gov.al

**Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit**
www.mrrtt.gov.al

**Ministria e Ekonimisë dhe Zhvillimit**
www.minek.gov.al

**Ministria e Integrimit Europian**
www.mie.gov.al

**Bashkia e Tiranës**
www.tirana.gov.al

**Departamenti i Administraës Publike**
www.pad.gov.al

# Njoftim

**(Vijon nga faqja 1)**

*Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e infomacionit të kërkuar.*

*Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.*

*Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga auto-riteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.*

*Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;*

***"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për infomim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.***

***Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30***

***Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP".***

**Denada BRESHANAJ**
Koordinatore Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascpdp.org